



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.10.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 24 tetor 2019
2. Seancë dëgjimore për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 12.02.2018
3. Seancë dëgjimore për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Adriatik Alimadhi, Aurora Mara, Elda Hoti, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Nikolin Staka dhe Ralf Gjoni

Mungojnë:

Edmond Leka, Tom Doshi dhe Ediola Braha

Të ftuar:

Arta Vorpsi - kandidate për të dyja shpalljet

A) kandidate për plotësimin e vakancës së plotë të shpallur në datën 12.02.2018

B) kandidate për plotësimin e vakancës së plotë të shpallur në datën 04.03.2019

Elsa Toska - kandidate për të dyja shpalljet

A) kandidate për plotësimin e vakancës së plotë të shpallur në datën
12.02.2018

B) kandidate për plotësimin e vakancës së plotë të shpallur në datën

04.03.2019

Fiona Papajorgji - kandidate për plotësimin e vakancës së plotë të shpallur në
datën 04.03.2019

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet e rendit të ditës.

Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të datës 24 tetor 2019.

A ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi seancë dëgjimore me kandidatët për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese të shpallura nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që i takojnë Kuvendit të Shqipërisë.

Siç jeni në dijeni, më datën 14.10.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë listën e kandidatëve për plotësimin e vendit vakant të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë, vakancë e plotë, në datën 12.02.2018, dhe listën me kandidatët për vakancën e plotë të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 04.03.2019. Bazuar në ligjin nr. 99 të vitit 2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, neni 7/c pika 5 e këtij ligji dhe në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni i Ligjeve organizon këtë seancë dëgjimore me kandidatët për në Gjykatën Kushtetuese.

Janë dy lista kandidatësh, është vakanca e shpallur më 12.02.2018 dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 130, datë 21.09.2019, i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant, vakancë e plotë e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 12.02.2018, kandidatët e renditur si më poshtë:

Arta Vorpsi, Elsa Toska dhe Besnik Muçi.

Pra është blloku i parë i kandidatëve për vakancën e shpallur nga Kuvendi në datën 21.02.2018. Ndërsa me vendimin nr. 134, datë 21.09.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant, vakancë e plotë e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 04.03.2019, si më poshtë:

Arta Vorpsi, Fiona Papajorgji dhe Elsa Toska.

Pra, referuar të dyja vendimeve të përcjella nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në Kuvendin e Shqipërisë, janë të njëjtët kandidatë që aplikojnë për të dyja vakancat e shpallura nga Kuvendi i Shqipërisë, thënë kjo, ne kemi thirrur në seancë dëgjimore tri kandidate: zonjën Arta Vorpsi, zonjën Elsa Toska dhe zonjën Fiona Papajorgji, ndërsa lidhur me kandidatin e vakancës së datës 12.02.2018, zotin Besnik Muçi, tashmë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kolegët kanë mbi tavolinë dekretin për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Zoti Muçi është zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese nga lista e Presidentit të Republikës dhe aktualisht është anëtar i Gjykatës Kushtetuese, prandaj nuk do të jetë pjesë e kësaj seance dëgjimore.

Do të kemi një seancë dëgjimore për të dyja vakancat, duke qenë se janë të njëjtët kandidatë, pra vakanca e datës 12.02.2018 dhe vakanca e plotë e shpallur nga Kuvendi në datë 04.03.2019, pastaj, në një seancë tjetër të Komisionit të Ligjeve, do të kemi një diskutim lidhur me vlerësimin e kushteve, kriterëve ligjore, meritës së secilit prej kandidateve, si dhe miratimin e raportit për secilin kandidat, që do t'ia dërgojmë seancës plenare, e cila me votim do të vendosë se cilët do të jenë anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese të zgjedhur nga Kuvendi.

Siç e dini, sipas ligjit, nëse asnjëri nga kandidatët nuk arrin të marrë 84 vota, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është automatikisht anëtar i zgjedhur i Gjykatës Kushtetuese. Sipas renditjes që është bërë po e fillojmë seancën dëgjimore me zonjën Arta Vorpsi.

Zonja Vorpsi, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve! Dokumentacioni juaj është përcjellë i plotë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për në Kuvendin e Shqipërisë dhe kolegët e mi të komisionit disponojnë dosjen tuaj të plotë sot në komision, por si për kolegët, ashtu dhe për opinionin publik do t'ju lutesha që të na parashtroni shkurtimisht cilat janë motivet dhe arsyet që ju shtynë të bëheni pjesë e garës për të qenë anëtare e Gjykatës Kushtetuese dhe cili është vizioni juaj nëse do të zgjidheni nga Kuvendi i Shqipërisë për të qenë anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Në praktikën tonë nga Këshilli i Emërimeve vijnë tri emra, pra është hequr emri i Besnik Muçit, por si është futur kandidati tjetër? Me çfarë procedure?

Ulsi Manja – Cili kandidat?

Adriatik Alimadhi – Për ta sqaruar. Te Këshilli i Emërimeve për Drejtësi kemi tri emra, Arta Vorpsi, Elsa Toska dhe Besnik Muçi. Tani ju na paraqitët një...

Ulsi Manja – Është te vendimi tjetër, more zotëri.

Adriatik Alimadhi – Dakord.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Fjala është për ju, zonja Vorpsi.

Arta Vorpsi – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit, i nderuar zoti kryetar, që më dhatë mundësinë të shprehem para këtij komisioni të nderuar lidhur me motivimin tim për të kandiduar në postin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese! Siç e thatë, ju e keni të gjithë përpara dosjen me CV-në time dhe me të gjithë dokumentacionin përkatës në shërbim të konkurrimit për vakancën në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë unë do të përmbledh shkurtimisht arsyet pse kam kandiduar.

Kam mbi 23 vjet përvojë jo vetëm si juriste, por edhe si ekspertë e të drejtës kushtetuese. Gjatë gjithë përvojës punën time si juriste e kam pasur të lidhur ngushtësisht me të drejtën publike, specifikisht me të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut. Kam përfunduar doktoratën në universitetin e Vjenës “Për të drejtën kushtetuese”, posaçërisht për gjykimin kushtetues, dhe kontribuoj në Gjykatën Kushtetuese që prej vitit 2001, fillimisht si drejtoreshë e Studimeve pranë kësaj gjykate dhe më pas nga viti 2005 si këshilltare ligjore e gjyqtarëve. Jo vetëm puna ime e përditshme ka qenë e lidhur me të drejtën kushtetuese, por edhe ajo jashtë saj, duke filluar me mësimdhënien, me kontributin që kam dhënë në botime të shumta brenda dhe jashtë vendit për çështje të ndryshme të së drejtës publike, specifikisht me të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut. Duke qenë se kam një përvojë të gjatë në Gjykatën Kushtetuese, e njoh mirë këtë institucion, jo vetëm nga pikëpamja institucionale dhe organizative, por edhe nga pikëpamja e praktikës, pra nga vendimmarrja substanciale e saj. Kështu që mendoj se kjo përvojë e gjatë e imja, e lidhur ngushtë me drejtësinë kushtetuese, është një motiv mjaft i mirë për të dhënë edhe më tej kontributin në këtë gjykatë, për ta çuar në një fazë tjetër të zhvillimit të jurisprudence-së së saj. Nuk e di a duhet të vazhdoj më tej, sepse dua të respektoj kohën tuaj të punë?

Ulsi Manja - Nuk ka problem.

A ka pyetje nga kolegët për zonjën Vorpsi?

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Përshëndetje, zonja Vorpsi!

Kam një pyetje që lidhet me formimin tuaj. A jeni pranuar në Shkollën e Magjistraturës pas përfundimit të procesit të testimit tuaj?

Arta Vorpsi – Unë nuk kam konkurruar për t’u pranuar në Shkollën e Magjistraturës, se nuk ka qenë ky qëllimi. Testi i zhvilluar ka qenë për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilit ishin të detyruar t’i nënshtroheshin dhe këshilltarët ligjorë pranë gjykatave në Republikën e Shqipërisë. Duke qenë se Shkolla e Magjistraturës nuk ka disa lloje testesh, por vetëm një test, që bëhet që nga viti i themelimit të saj, të gjithë këshilltarët, përveç punonjësve

të tjerë, iu nënshtroan këtij testimi, i cili do të shërbente bashkë me vlerësimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të na vlerësuar nëse ishim të aftë të mbanim vendin e punës si këshilltar ligjor. Pra, në asnjë moment, as unë dhe as kolegët e mi në Gjykatën Kushtetuese nuk kanë konkurrar me idenë për t'u bërë gjyqtarë të Republikës së Shqipërisë, prandaj dhe nuk kam konkurrar për atë vend dhe sigurisht që nuk jam pranuar.

Ulsi Manja – Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Sa pikë keni marrë në testim dhe sa pikë kërkohen që të pranohesh në Shkollën e Magjistraturës?

Pyetja e dytë, që të mos reagojnë kolegët e mi të Partisë së Punës, a keni pasur ndonjëherë ndonjë angazhim direkt apo indirekt me ndonjë parti politike, ose grupim politik në Shqipëri?

Arta Vorpsi – Lidhur më pyetjen e parë, në dijeninë time, është 60 pikë të testit *Scantron*, që quhet, dhe e njëjta gjë është edhe për testin profesional. Nëse e keni fjalën për pikët e *Scantron*-it, unë kam marrë 57 pikë, pra tri pikë më pak. Për sa i përket pyetjes së dytë, nuk kam qenë asnjëherë e angazhuar me ndonjë parti apo grupim politik.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Vorpsi!

I tërheq vëmendjen zotit Gjoni për respektimin e Kodit të Etikës në komunikimin me kolegët, kod i cili është votuar me konsensus në Kuvend dhe është i detyrueshëm për zbatim. Kështu që me të gjithë respektin që kam për kolegët, Kodi i Etikës duhet të respektohet.

A ka pyetje të tjera për zonjën Vorpsi? Nuk ka.

Zonja Vorpsi, shumë faleminderit për praninë tuaj në Komisionin e Ligjeve! Siç e thashë edhe në fillim, lidhur me vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve, por edhe të meritës së kandidaturës suaj, ne do të zhvillojmë një diskutim në një mbledhje tjetër të Komisionit të Ligjeve pa praninë tuaj dhe më pas votimin e raportit për në Kuvendin e Shqipërisë.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Arta Vorpsi – Faleminderit juve dhe punë të mbarë!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me kandidaten e dytë, zonjën Elsa Toska.

Ju lutem, pak qetësi!

Zonja Toska, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Edhe ju jeni një nga kandidatet për të dyja vakancat e shpallura nga Kuvendi për të qenë anëtare e Gjykatës Kushtetuese. Dokumentacioni është përcjellë i plotë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Kolegët e mi të komisionit janë njohur paraprakisht me dokumentacionin tuaj, ndaj sot për kolegët dhe për opinionin publik ju lutem, shkurtimisht, na

paraqisni motivet, shkaqet dhe arsyet që ju shtynë për të qenë një nga kandidatet e zgjedhura nga Kuvendi për në Gjykatën Kushtetuese. Çfarë do t'i ofronit ju Gjykatës Kushtetuese, nëse do të merrnit pëlqimin e Kuvendit, sipas ligjit?

Fjala është për ju.

Elsa Toska – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Jam e nderuar që ndodhem sot para jush si kandidate e Gjykatës Kushtetuese, produkt i një procesi sa sfidues, aq edhe meritokratik në vlerësimin tim. Kam 19 vjet përvojë pune, 12 prej të cilave i kam në drejtësinë kushtetuese dhe të drejtat e njeriut. E gjithë eksperiencia ime dhe interesat profesionale janë fokusuar në këtë fushë qoftë në nivel teorik, qoftë në nivel praktik. Në nivel teorik, mbaj gradën shkencore “Doktore e shkencave”, ndërsa në nivel praktik të gjitha angazhimet e mia, parësore ose dytësore, si: në mësimdhënie, trajnime, ekspertizë, artikuj, konferenca dhe botime, i kam fokusuar në çështjet e të drejtave të njeriut.

Të nderuar deputetë,

Nuk dua të ndalem dhe të flas shumë për veten, pasi CV-në time dhe vendimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi e dispononi, por dua të ndalem, dhe besoj unë që ju do të dëshironit më tepër të dëgjoni për objektivat që mendoj unë se duhet të ketë Gjykata Kushtetuese (pra objektivat institucionale) për vizionin që unë kam për këtë gjykatë dhe sfidat të cilat e presin atë.

Sigurisht, në këtë këndvështrim, do të mundohem të sjell para jush edhe vlerën time të shtuar për përbërjen e re të Gjykatës Kushtetuese.

Në vizionin tim, Gjykata Kushtetuese duhet të orientohej në të ardhmen në vendimmarrjen e saj në forcimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; në forcimin e parimeve të shtetit të së drejtës dhe demokracisë kushtetuese; në promovimin e vlerave, si drejtësia, siguria juridike dhe paanësia gjatë gjykimit kushtetues; në forcimin e legjitimitetit për vendimmarrjen e saj. Po ashtu, unë mendoj se Gjykata Kushtetuese duhet të jetë facilituese e proceseve demokratike dhe aksesit të çdo grupi shoqëror në shërbimet publike; duhet të bëhet neutralizuese e debateve politike dhe publike kur këto bëhen pjesë e kontrollit kushtetues dhe, sigurisht, kur në to ka pyetje kushtetuese; duhet të bëhet dhe duhet të jetë agjente e ndryshimeve sociale duke iu përgjigjur ose duke u paraprirë ndryshimeve sociale.

Të nderuar deputetë,

Objektivat që sipas meje duhet të ketë Gjykata Kushtetuese, ku unë do të përpiqem të jap kontributin tim që të bëhen edhe objektiva institucionale (pasi, sigurisht, Gjykata Kushtetuese do të ketë nëntë anëtarë, unë do të kem rolin tim si një anëtare e ardhshme potencialisht, por që trupa është kolegjiale dhe objektivat janë institucionale), do të jenë të tilla

që të fokusohen në ruajtjen dhe vazhdimësinë e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese; në krijimin e një jurisprudence të re postreformë me ndryshimet e mëdha që kanë sjellë në juridiksion dhe kompetencë Kushtetuta dhe ligji “Për Gjykatën Kushtetuese”; në rritjen e efikasitetit dhe të efikasitetit sipas standardeve më të mira të standardeve të CEPES-it (Komisionit për Efikasitetin në Këshillin e Europës); në përmirësimin e integritetit institucional nëpërmjet praktikave të brendshme administrative që inkurajojnë transparencë, llogaridhënie, shmangie të konfliktit të interesit, sjellje dhe komunikim etik me publikun dhe me medien. Eventualisht, të gjithë këta objektiva mendoj se do të sjellin objektivin madhor: rritjen e besimit të publikut në Gjykatën Kushtetuese dhe në drejtësinë kushtetuese.

Ne tashmë e dimë se sfida kryesore e Gjykatës Kushtetuese është rikthimi në një sistem funksional dhe të bërit një mjet ankimi efektiv, por brenda kësaj sfide të madhe, në këndvështrimin tim, ka edhe disa sfida të tjera. Në fakt, sfidat janë aktuale dhe ne i dimë. Gjithsesi, mendoj se duhet të sjell para jush sfidën e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me disa kompetenca të shtuara të Gjykatës Kushtetuese, që janë ende të patestuara në praktikë. Ankimi kushtetues individual substancial hyri në fuqi në muajin mars të vitit 2017, por për shkak të mungesës së kuorumit Gjykata Kushtetuese nuk arriti ta testojë. Pritshmëritë e avokatëve, pritshmëritë e kërkuesve janë të mëdha, gjë që shihet edhe nga kërkesat që sjellin në Gjykatën Kushtetuese, ndaj uroj që përbërja e re të bëjë interpretimin përkatës në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, por edhe me frymën dhe qëllimin e ankimit kushtetues substancial.

Gjithashtu, për mendimin tim, menaxhimi i burimeve njerëzore është një element që duhet rikonceptuar, sidomos kërkimi shkencor i Gjykatës dhe menaxhimi i çështjeve.

Një sfidë e tretë dhe tejet aktuale është ekzistenca e rreth 120 çështjeve në shqyrtim, por edhe ndërtimi i një modeli efektiv të menaxhimit të çështjeve. Ne kemi 120 çështje në shqyrtim, por, sigurisht, me bërjen funksionale të Gjykatës së Lartë, numri i çështjeve do të rritet potencialisht. Kështu që unë mendoj se Gjykata duhet të ndërtojë një plan veprimi dhe një strategji, si dhe më e rëndësishmja, një model efektiv të menaxhimit dhe të përballimit të çështjeve.

Nuk dua të lë pa përmendur këtu një nga sfidat, le të themi, përsëri edhe kjo nga më aktualet për Gjykatën Kushtetuese, siç është ndërtimi i një plani strategjik për marrëdhëniet me medien dhe, eventualisht, edhe me publikun. Mendoj se ndryshimet postreformë kanë sjellë një vëmendje të shtuar rreth Gjykatës Kushtetuese. Interesi është më i lartë për veprimtarinë e saj dhe ka impakt social, ekonomik dhe politik. Ndërtimi i një filozofie të një gjykate të hapur

dhe transparente, si dhe i një plani strategjik me medien, mendoj se është një nga sfidat e kësaj gjykate dhe, le të themi, një nga prioritetet e saj.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, si një nga sfidat e Gjykatës do të veçoja zhvillimin e strategjive të zgjeruara për komunikimin dhe përthithjen e eksperiencave ndërkombëtare. Këtu do të veçoja sidomos avancimin e marrëdhënies së Gjykatës Kushtetuese me Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut dhe gjykatat kushtetuese europiane, si dhe bashkëveprimin me organizatat ndërkombëtare apo me donatorë të ndryshëm, të cilët duan ta asistojnë këtë gjykatë apo duan ta ndihmojnë atë qoftë në çështjet menaxheriale administrative, qoftë në çështjet e kontrollit kushtetues.

Të nderuar deputetë,

Uroj të më jepni përgjegjësinë e madhe të të qenit anëtare e Gjykatës Kushtetuese, si dhe besimin tuaj se këtë detyrë do ta ushtroj me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Toska!

Ka pyetje nga kolegët për zonjën Toska?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Nuk kam ndonjë vërejtje, madje jam plotësisht dakord me vizionin që paraqisni ju, kam vetëm një sqarim. Si e gjykoni aktualisht ligjin aktual “Për Gjykatën Kushtetuese”? Ju e njihni shumë mirë, sepse jeni doktoreshë e fushës, por do të doja një opinion për ligjin e Gjykatës Kushtetuese. A ka ardhur koha për ta ndryshuar?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Ju lutem, zonja Toska, një përgjigje për kolegun.

Elsa Toska – Faleminderit për pyetjen!

Ligji “Për Gjykatën Kushtetuese” është një ligj, i cili u ndryshua me ndryshimet postreformë dhe ku u rregulluan ato gjëra që gjatë jurisprudencës disavjeçare të Gjykatës nxorën mangësi, por, gjithashtu, ai ligj u ndërtua edhe mbi modelet më të mira të ligjeve për gjykatat kushtetuese në Europë.

Unë mendoj që ligji është më i miri i mundshëm, është bërë nga ekspertët e fushës dhe besoj se do t’u përgjigjet sfidave të kësaj gjykate për të ardhmen. Nëse do të ketë nevojë për ndryshime, mendoj se është ende herët të flasim, por besoj se ligji reflekton standardet më të mira në çështjet e të drejtave të njeriut dhe të kontrollit kushtetues.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Toska!

Zoti Alimadhi ka kërkuar fjalën për pyetje.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Toska!

Në fakt, po e lexoj për herë të dytë, me thënë të drejtën, ju jeni ngarkuar të përgatisni dhe të relatonit gjithsej 43 vendime, apo jo? Nga këto, keni dhënë 17 vendime përfundimtare dhe 26 vendime moskalimi. A ka mundësi të na thoni, si ka ardhur si proces moskalimi i këtyre 26 vendimeve? A ka ardhur nga moszbatimi ose mosdhënia e vendimeve të mëparshme të padrejta, apo ka diçka tjetër teknikisht nuk shkon dhe ju i keni kthyer mbrapsht.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Zonja Toska, pa dashur t'ju orientoj në përgjigje, sepse ju jeni e lirë ta çmoni vetë përgjigjen që jepni, nuk duam detaje në lidhje me përmbajtjen e çështjeve që janë gjykuar ose janë në gjykim në Gjykatën Kushtetuese.

Faleminderit!

Elsa Toska – Faleminderit për sugjerimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Si s'lejohej? Ju lutem pra! Ku e dini ju se ku është qëllimi im? Ju sikur e dini qëllimin tim.

Ulsi Manja – Dakord! Ju thashë: ajo e ka në vlerësimin e saj përgjigjen.

Adriatik Alimadhi – Ju lutem! Nuk keni të drejtë, pra. Ajo le të kthejë përgjigjen e saj.

Ulsi Manja – Ajo le të japë përgjigjen që dëshiron të japë.

Adriatik Alimadhi – Tani, ajo është kandidate për anëtar të gjykatës Kushtetues.

Ulsi Manja – Është kandidate, nuk është anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

Adriatik Alimadhi – Kandidate pra, në rregull!

Ka kryer një proces pune. Nga momenti që e ka relatuar 43 çështje, unë po them: 17 i ka kaluar, dhe 23... A ka mundësi të na japë një mendim se cili është shkaku? Pse?

Ulsi Manja – S'është gjyqtare ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Toska, ju lutem, jepni përgjigjen që dëshironi të jepni!

Elsa Toska – Faleminderit!

Vendimet janë të Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e moskalimit janë vendime kolegjii ose vendime të mbledhjes së gjyqtarëve. Do të thotë se unë kam përgatitur opinionet paraprake për vendimet dhe pastaj kam draftuar vendimet sipas orientimit që më është dhënë nga kolegjii, nga paneli prej tre gjyqtarësh ose nga mbledhja e gjyqtarëve.

Më lejoni t'ju them paraprakisht, ju lutem, se përgjithësisht, sidomos vitet e fundit, në Gjykatën Kushtetuese jam marrë me kontrollin incidental. Do të thotë se jam marrë me çështje që investohen nga Gjykata Kushtetuese nga gjyqtarët e zakonshëm, pra me kontrollin incidental, dhe kam përshtypjen se statistika aty i përket pikërisht kësaj periudhe.

Unë vetë gjykoj se në pjesën më të madhe të çështjeve kam dhënë vendime moskalimi, bazuar mbi faktin e legjitimitetit të gjykatave të zakonshme për të investuar Gjykatën Kushtetuese.

Megjithatë, më konkretisht, duhet të hyjmë nga çështja në çështje, për të parë edhe diferencat.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Toska!

Zoti Gjoni ka kërkuar fjalën për pyetje.

Ralf Gjoni – Zoti kryetar, në përgjigje edhe të ndërhyrjes suaj të mëparshme, ju falënderoj për tërheqjen e vërejtjes! Jam dakord me ju, që të gjithë kolegët duhet ta respektojnë njëri-tjetrin. Me shumë xhentilesë, do të doja t'ju kërkoja që kolegët e maxhorancës të na respektojnë kur bëjmë pyetje, edhe nëse bëjmë pyetje të gabuara, sepse kur bëjmë pyetje, besoj se jemi në të drejtën tonë të ushtrimit të detyrës së deputetit, ndonëse ato pyetje mund të mos u pëlqejnë disa deputetëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë për elaborimin e së kaluarës së këtij vendi.

Zonja Toska, kjo s'ka të bëjë me ju personalisht, por kam vënë re se të gjithë kandidatët që kanë ardhur sot përballë këtij komisioni, në eksperiencën e tyre arsimore nuk e kanë Shkollën e Magjistraturës. Këtë pyetje ia drejtova edhe kandidatës që ishte para jush, ndaj do të doja një përgjigje koncize e të sqartë: sa pikë keni marrë ju gjatë procesit të testimit, dhe a kanë qenë të mjaftueshme ato pikë për të hyrë në Shkollën e Magjistraturës?

Pyetja e dytë që kam, është hipotetike. Pra, nëse ju do të ishit anëtare e Gjykatës Kushtetuese sot, ose jo sot, por gjatë kohës së shqyrtimit të ligjit “Për vetingun”, a do të kishit votuar ju për pezullimin e efekteve të këtij ligji apo jo? Gjithnjë nëse është e mundur të përgjigjeni, pa ju vënë në siklet.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Zonja Toska, një përgjigje për pyetjet e kolegut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Fino!

Po, zonja Toska!

Elsa Toska – Faleminderit për të dyja pyetjet. Në lidhje me pyetjen e parë, më lejoni t’ju them paraprakisht, që unë kam qenë subjekt rivlerësimi për të tre komponentët e rivlerësimit: figurën, profesionalizmin dhe pasurinë.

Organi kushtetues i caktuar me tagrin për të bërë vlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit, është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Testi i magjistraturës ka qenë një pjesë për t’u vlerësuar në komponentin profesional, nga tërësia e tre komponentëve.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi konfirmimin tim në detyrë, gjë që do të thotë se mori në konsideratë dhe vlerësoi tërësinë e profilit tim, përfshirë edhe testin e magjistraturës. Kjo ishte në parim. Në konkret, sigurisht mund t’ju them se tek testi profesional, vetë provimi ishte i përbërë nga dy komponentë: testi profesional dhe testi i një natyre të përgjithshme. Në testin profesional kam marrë mbi 75 % të pikëve të kërkuara, nga 60 %, ndërsa në testin e një natyre të përgjithshme nuk arrita ta merrja 60-përqindëshin.

Pyetja e dytë ka të bëjë me ligjin “Për vetingun” dhe qëndrimin që do të mbaja unë në lidhje me pezullimin, nëse do të isha gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, lidhur me pezullimin e efekteve.

Pavarësisht se sot flas nga pozitat e të qenit shumë mbrapa në kohë, në parim mund të them se Gjykata Kushtetuese, me interpretimin pajtues që i bëri ligjit “Për vetingun”, veproi në mënyrën më të mirë të mundshme, kjo edhe me asistencën e Komisionit të Venecias. Kësisoj, mendoj se nuk do të kisha votuar për pezullimin e ligjit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Toska!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Kam unë një pyetje të fundit, zonja Toska, para se të mbarojmë seancën dëgjimore me ju. Zonja Toska, ju thatë se në Gjykatën Kushtetuese janë rreth 120 çështje, që pritet të shqyrtohen Gjykata Kushtetuese kur ajo të bëhet funksionale, dhe shpresoj ta kemi funksionale shumë shpejt. Mes atyre çështjeve ka edhe çështje që janë shumë delikate, shumë sensitive për opinionin publik, pasi për disa kohë kanë mbërthyer debatin politik, mes palëve politike në Shqipëri, çështje të cilat kanë një pritshmëri nga opinioni publik lidhur me vendimmarrjen që do të ketë Gjykata Kushtetuese.

Në këtë pikë shtrohet me të madhe çështja e ruajtjes së pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese. Si do ta ruani ju pavarësinë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe jo vetëm, por edhe të ushtrimit të funksioneve tuaja si anëtare e Gjykatës Kushtetuese, nëse do të arrinit të merrnit votat e Kuvendit për të qenë anëtare e Gjykatës Kushtetuese? Sepse çështja e pavarësisë së

institucionit, çështja e pavarësisë së gjyqtarëve në raport me Kushtetutën dhe ligjin, është çështje shumë e debatueshme sot, e jo vetëm sot, por besoj se edhe për shumë kohë.

Elsa Toska – Faleminderit, zoti Manja!

Sa i takon çështjes së pavarësisë, sipas mendimit tim ajo mund të jetë pavarësi objektive dhe subjektive. Pavarësinë objektive, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese ia kanë siguruar normat kushtetuese dhe normat ligjore. Në lidhje me pavarësinë subjektive, unë mund të flas vetëm për integritetin tim personal e për trajektoren profesionale të jetës sime, e cila mendoj se më ka formësuar me parime dhe me një metodologji dhe një kulturë punë, që të jap garancitë e nevojshme për këtë lloj pavarësie.

Në lidhje me pavarësinë objektive, unë mendoj se ajo është e sanksionuar shumë mirë në Kushtetutë e në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është një premisë shumë e mirë, që çdo gjyqtar i ardhshëm i Gjykatës Kushtetuese të ketë garancitë e mjaftueshme për të vepruar me objektivitet.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Toska!

Nuk ka pyetje të tjera nga kolegët. Në vlerësimin e kandidaturës suaj, lidhur me përmbushjen e kushteve e kriterëve, por edhe të meritës së kandidaturës pas kësaj seance dëgjimore, do ta vlerësojmë në një mbledhje të radhës të Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit edhe një herë dhe ditë të mbarë!

Vazhdojmë me kandidaten e tretë në radhë, që është edhe e fundit, zonjën Fiona Papajorgji.

Zonja Papajorgji, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Edhe ju jeni një nga kandidatet për një vakancë të plotë, të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 4, 3, 2019, për në Gjykatën Kushtetuese.

Pra, zonja Papajorgji kandidon vetëm për njërën nga vakancat, jo në të dyja vakancat, dhe jeni kualifikuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr.134 dhe jeni pjesë e listës, e cila do t'i dërgohet seancës plenare.

Sipas nenit 7/c të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, por edhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni i Ligjeve, përpara miratimit të raportit për seancën, organizon një seancë dëgjimore me kandidatët për Gjykatën Kushtetuese.

Ju jeni sot përpara Komisionit të Ligjeve për të shpalosur vizionin tuaj nëse do të arrini të merrni votëbesimin e parlamentit për të qenë anëtare e GJK-së, pasi pjesa tjetër që ka të bëjë me dokumentacionin, i cili na ka ardhur i plotë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe kolegët e mi të komisionit e kanë mbi tavolina.

Do t'ju lutesha shkurtimisht të na flitni për motivet, shkaqet, arsyet dhe vizionin tuaj si kandidate e më pas si anëtare e GJK-së nëse do të votëbesoheni nga Kuvendi.

Urdhëroni!

Fiona Papajorgji – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Ju tashmë keni dokumentacionin që ka të bëjë me kandidaturën time, sikurse tha edhe kryetari i komisionit.

Shkurtimisht, do të paraqes vizionin tim dhe arsyet e këtij kandidimi.

Duke lëmë mënjanë aspektin e kualifikimit profesional dhe atij akademik, në dhjetëvjeçarin e fundit jam pjesë e strukturës së GJK-së, prej vitit 2011 si këshilltare e GJK-së, çka më ka ndihmuar që të njoh nga afër gjithë procesin e vendimmarrjes në GJK nëpërmjet dhënies së opinioneve, përgatitjes së gjithë materialeve për të gjitha çështjet, jo vetëm për ato që janë trajtuar nga unë personalisht, por në një këndvështrim më të gjerë mbi të gjitha çështjet e GJK-së.

Si aspekti profesional, ashtu edhe ai akademik, nisur nga kjo eksperiencë në fushën e së drejtës e sidomos në fushën e të drejtave të njeriut, mendoj se plotësoj kushtet të cilat tashmë janë përcaktuar dhe janë analizuar nga KED-ja, prandaj kam kandiduar për vendin kandidat për gjyqtar kushtetues.

Misioni dhe ajo çka mendoj unë për këtë kandidim është se do t'i përmbahem funksioneve të GJK-së, epërsisë së Kushtetutës, respektimit, garantimit, por ajo çka dëshiroj të theksoj është konsolidimi, njësimi i vendimmarrjes dhe jurisprudencës së GJK-së, nga njëra anë, por edhe evoluimi i kësaj jurisprudence duke u bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, por edhe në jurisprudencën e gjykatave të tjera homologe simotra, të cilat në parimet kushtetuese dhe në vlerat kushtetuese tashmë kanë një vendimmarrje të avancuar.

Në fakt, në familjen e gjykatave kushtetuese, jona është një gjykatë relativisht e re, por, pavarësisht kësaj, e ushqyer me praktikat më të mira të gjykatave të tjera dhe ka shpalosur tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila duhet të njësohet (pasi ka gjithmonë vend për përmirësime), pasi GJK-ja nëpërmjet vendimmarrjes së saj ka bërë edhe ndryshim të praktikave bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtëve të Njeriut.

Ajo çka doja të theksoja është nga njëra anë njësimi dhe konsolidimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, por edhe evoluimi i saj në frymën e standardeve të reja kushtetuese. Mendoj se ka ardhur koha që GJK-ja të kalojë në një stad të ri, atë të përforcimit të parimeve kryesore dhe vlerave kushtetuese, nga njëra anë, për të përcaktuar atë që është tradita, identiteti

kushtetues dhe, nga ana tjetër, në dialog si me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ashtu edhe me gjykatat e tjera ndërkombëtare për të përcaktuar atë që është një traditë e përbashkët kushtetuese në rrugën drejt europianizimit apo konstitucionalizmit të së drejtës kushtetuese.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Papajorgji!

A ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja kandidate për anëtare të GJK-së!

Në fakt, në të dhënat tuaja nuk është se del qartësisht se ku keni punuar dhe ku e keni ushtruar aktivitetin e avokatit, në Shqipëri apo në Itali.

Fiona Papajorgji – Unë e anashkalova këtë pjesë, pasi mendova se nga dokumentacioni rezultonte, megjithatë po e përsëris.

Kam përfunduar studimet universitare në Itali. Menjëherë pas përfundimit të studimeve universitare, po në Itali kam filluar, në bazë të legjislacionit italian në fuqi, stazhin si praktikante avokate pranë një zyre avokatie në Itali. Për këtë qëllim jam regjistruar në Dhomën e Avokatisë në Itali si praktikante avokate që në vitin 2000.

Pasi kam përfunduar stazhin e detyrueshëm dyvjeçar, i jam nënshtruar provimit të kualifikimit për të marrë titullin “Avokat”, sipas procedurave me shkrim dhe me gojë, në dhjetor të vitit 2003. Qysh prej janarit të vitit 2004 kam qenë e regjistruar në Dhomën e Avokatisë në Itali, ku kam ushtruar profesionin e avokatit deri në fund të vitit 2008.

Adriatik Alimadhi – Kam edhe një pyetje tjetër që është pak a shumë me të njëjtën përmbajtje me të kandidaturës që kaloi. Rezulton se kandidatja, pra ju, është ngarkuar që të përgatisë dhe ka relatuar gjithsej 159 çështje nga të cilat janë dhënë 39 vendime përfundimtare dhe 120 vendime moskalimi.

A ka mundësi të dimë se cila është arsyeja e këtyre 120 vendimeve?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Urdhëroni, zonja Papajorgji!

Fiona Papajorgji - Faleminderit!

Në fakt, raporti i gjithë vendimmarrjes së GJK-së është pothuajse 20-30% të çështjeve apo ankesave që paraqiten para GJK-së kanë kaluar në seancë plenare, ku është marrë një vendim përfundimtar, ndërsa pjesa tjetër, rreth 70%, kanë qenë normalisht vendime moskalimi. Kjo për një sërë arsyesh, kohët e fundit edhe për shkak të ndryshimeve në ligjin organik të GJK-së, sepse nuk është respektuar, kryesisht, nuk është bërë akoma i njohur nga të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, pra nuk është metabolizuar afati i ri i përcaktuar për

kundërshtimin e vendimeve gjyqësore, sepse dihet që pjesa më e madhe e vendimmarrjes së GJK-së ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor, pra me vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Ky është shkaku i parë, por lidhet vetëm me pjesën e fundit të jurisprudencës dhe vendimmarrjes së GJK-së. Ndër vite shkaqet kryesore kanë qenë mosngritja e kërkesës në nivel kushtetues (pra ankesat nuk kalonin në seancë plenare dhe rrjedhimisht për to nuk merrej një vendim përfundimtar), prandaj ato kanë vendime moskalimi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Papajorgji!

Urdhëroni, zoti Gjoni!

Ralf Gjoni - Faleminderit!

Të kthehemi pas në kohë, në vitin 2016, kur PD-ja ankimoi në GJK ligjin për vetingun. Në pritje të vendimit nga Komisioni i Venecias, GJK-ja vendosi pezullimin e tij, i cili në gjykimin tim solli një efekt rokadë në vonesa të panevojshme të zbatimit të afateve kushtetuese të ngritjes së organeve të vetingut, madje sjell në kujtesë se një nga shqetësimet e para të Komisionit të Venecias pa filluar reforma në drejtësi ka qenë pikërisht marrja e masave për garantimin e vazhdimësisë institucionale gjatë zhvillimit të procesit të vetingut për të mos mbërritur në këtë pikë ju jemi sot, me një vakim tmerrësisht të madh institucional.

Ju, nëse do të ishit anëtare e GJK-së në atë kohë, do ta kishit votuar pezullimin e atij ligji, apo jo?

Fiona Papajorgji – Për shkak të rëndësisë së madhe që pati ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe për efektet që ai mund të sillte në rast se nuk do të pezullohej kërkesa.

Së pari, duhet të dimë se pezullimi i zbatimit të ligjit varet në bazë të kriterëve rigoroze të përcaktuara nga Kushtetuta dhe nga ligji organik i Gjykatës Kushtetuese. Për efektet që mund të sillte, nëse ai ligj do të zbatohet para një vendimmarrjeje të Gjykatës Kushtetuese, mendoj se gjithmonë duhet të ketë një balancë të interesave, sepse është shumë thjeshtë të flasim, ta pezullojmë apo jo në mënyrën më të thjeshtë, por duhet të ketë një balancim të interesave që janë në lojë. Mendoj se pezullimi në atë kohë ishte i nevojshëm për këtë balancim të interesave.

E kuptoj shumë mirë shqetësimin për vonesat që mund të ketë sjellë, por mendoj se pezullimi i atij vendimi në atë kohë ishte shkaku më i vogël i vonesave të paraqitura. Shkaqet e tjera nuk janë varur nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese. Ajo vendimmarrje, duke përdorur teknikën e interpretimit pajtues, si përfundim, në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, mendoj se ishte nga më të mirat për funksionimin e vetë ligjit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Papajorgji!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zonja Papajorgji, për të qenë më të qartë, kur e filluat ushtrimin efektiv të profesionit të avokatit në Itali?

Fiona Papajorgji – Në muajin janar të vitit 2004.

Ulsi Manja – Në janar të vitit 2004?

Fiona Papajorgji – Po, në janar të vitit 2004 jam regjistruar në Dhomën e Avokatisë me titullin “Avokat”. Më parë kam qenë e regjistruar me titullin “Praktikante Avokate”.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Nuk ka pyetje të tjera nga kolegët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, pasi të përcjellim zonjën Papajorgji!

Zonja Papajorgji, faleminderit për prezencën sot në komision!

Edhe për ju vlen i njëjti rregull, pra vlerësimin dhe plotësimin e kushteve, të kriterëve ligjore dhe të meritës së kandidaturës suaj, ne do t’i diskutojmë në Komisionin e Ligjeve në mbledhjen tjetër të radhës. Më pas do të miratojmë raportin për në seancë plenare, gjithmonë nëse i plotësoni ose jo kushtet dhe kriteret për të qenë pjesë e votimit në seancë plenare.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Zoti Alimadhi, vazhdoni para se të mbyllim mbledhjen e komisionit.

Adriatik Alimadhi – Zoti kryetar, të them të drejtën, unë ngelem jo i plotë për këtë mbledhje. Kjo ishte shumë e dobishme edhe për shkak të tri kandidaturave, që janë kandidatë për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Do të doja shumë që deputetët e pozitës të kishin më shumë pyetje, por kjo tregon procedurën tuaj të ndjekur qartësisht, që kandidatët i keni propozuar ju me të gjitha të dhënat dhe, me sa duket, ju do t’i kaloni. Mendoj se e keni të njëanshme përzgjedhjen dhe jo në bazë të meritës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Mund ta kishit kursyer këtë diskutim për mbledhjen tjetër, kur të diskutojmë meritën e kandidaturave.

Unë dua të falënderoj kolegët sot për korrektësinë në këtë seancë dëgjimore me kandidatët për Gjykatën Kushtetuese!

Kjo mbledhje tregon seriozitetin e kësaj maxhorance dhe të kolegëve të komisionit për interesin, për të pasur sa më shpejt funksionale Gjykatën Kushtetuese, përkundër atyre që deri më sot janë bërë pengesë që ne të mos e kishim Gjykatën Kushtetuese. Duhet ta kishim

funkSIONALE shumë kohë më parë nëse do të kishte pasur konstruktivitet në këtë proces, por, gjithsesi, më mirë vonë se kurrë. Shumë shpejt do ta kemi Gjykatën Kushtetuese.

Falënderoj median për korrektësinë në pasqyrimin e kësaj seance dëgjimore!

Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Këtu mbyllet mbledhja e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA